


# PA NE



# S'KA DEMOKRACI

## ZËRI I POPULLIT

DENIZ (10), ALTIN (11), OLTİ (10), ANESA (10), LEON (11), RINA (10), ELMEDINA (10), ENDRIT (10),

FATLINDA (10), ENSAR (10)



### Ne gjatë ditës së sotme kemi ardhur në Punëtorinë për Demokraci dhe kemi mësuar për demokracinë dhe për elementet e saj

Demokracia është formë e qeverisjes, që nënkupton të drejtën e barabartë të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrje. Demokracia paraqet: lirinë, barazinë, tolerancën, kompromisin, pjesëmarrjen, solidaritetin, paqen, drejtësinë, etj. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke, ku fjala „demos“ do të thotë popull dhe



Ja si duket një vend-votim

fjala „kratos“ do të thotë qeverisje apo pushtet. Nga kjo mësojmë se demokracia është qeverisje e popullit. Demokracia ndahet në dy forma: në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe demokracinë përfaqësuese. Demokracia është formuar para 2500 vjetëve në Athinë, në kryeqytetin e Greqisë. Kjo ishte demokracia e drejtpërdrejtë, ku populli vendoste aty për aty. Ndërsa, në

demokracinë përfaqësuese populli voton deputetët, të cilët pastaj marrin vendime në emër të qytetarëve. Prandaj, Kuvendi quhet shtëpia ku dëgjohet zëri i popullit.

Gjatë kësaj punëtorie ne kemi diskutuar për solidaritetin. Solidariteti është kur ne i ndihmojmë njëri-tjetrit. Një shembull i mirë për këtë është E Shenjta Nëna Terezë e cila ka ndihmuar shumë fëmijëve në botë, sidomos fëmijëve në qytetin e Kalkutës në Indi. Shembull i mirë për tolerancën mund të jenë edhe rastet kur ne mund të kemi ndonjë mosmarrëveshje apo problem në mes vete. Ne problemet i zgjidhim duke biseduar, duke bashkëpunuar dhe duke bërë kompromise me njëri-tjetrin. Ka shumë raste kur njerëzit përdorin më shumë tolerancën sesa grindjen dhe pikërisht për këtë është demokracia.


Ne mendojmë se demokracia është ardhmëria jonë.



Gazetarët e vegjël



Faktet tona për procesin zgjedhor i cili ndodh në Kosovë




Të lirë ashtu si pëllumbi i paqes




Kur rritemi bashkë, edhe punojmë bashkë



Edhe pse të vegjël, ne mësojmë për zgjedhjet demokratike



Kushtetuta ime!



Ne mendojmë se barazia racore ka vend të rëndësishëm në demokraci. Pa të, askush nuk do të ishte i lumtur



## ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

LEUNTINA (11), ENDRITI (11), FLAMUR (11), ELTON (11), VALDRIN (11), NYRTENE (11), SARA (10),  
ORGESA (10), SUELA (10)

**Lexues të dashur, duhet ta dini se procesi zgjedhor luan një rol të rëndësishëm në jetën e të gjithë neve që jetojmë në demokraci**

Diskutimi ynë në grup filloi pikërisht me zgjedhjet. Zgjedhje këto që i bëjmë çdo ditë. Për shembull, grupi ynë ka zgjedhur emrin „Gazetarët e Vegjël“ që të identifikohemi në bazë të këtij emri. Këto janë zgjedhje të përditshme. Kurse, zgjedhjet shtetërore janë një proces shumë i rëndësishëm që ndodh në vende demokratike. Ky proces në vendin tonë ndodh çdo 4 vjet. Në këtë proces ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë. Duhet ta dini se një votë e juaja është vendimmarrëse. Në klasën tonë një shoku ynë për një votë nuk është zgjedhur kryetar i klasës. E shihni pra, sa e rëndësishme është një votë e juaj? Prandaj, asnjëherë mos dyshoni në pjesëmarrjen tuaj në procesin zgjedhor. Kjo sepse vendi ynë do të ndryshojë me votat tona.



Gazetarët e vegjël



Ndryshimi jemi të gjithë ne




Voto për të mirën e vendit tënd



Procesi më i rëndësishëm që ndodh në vende demokratike është procesi zgjedhor. Bëhu edhe ti pjesë e tij

# NE JU VOTOJMË, JU NA PËRFAQËSONI

ETNIK (11), DRIJON (10), FERIDE (10), BESMIR (11), FLORIM (11), ARNIS (10), DELVINA (10),  
ALMIR (10), ERONISA (11)



## Për të kuptuar dhe mësuar më shumë për demokracinë dhe Kuvendin e Kosovës mund ta lexoni këtë artikull

Ne në Punëtorinë e Demokracisë mësuam shumë gjëra. Tema jonë ishte Kuvendi. Përmes lojërave dhe aktiviteteve të ndryshme, ne mësuam shumë lehtë për Kuvendin.

Kuvendi është organ legjislativ. Ai miraton ose nuk miraton ligjet, miraton buxhetin, etj. Kuvendi i Republikës së Kosovës është i përbërë nga 120 deputetë. Këta janë të përzgjedhur me anë të votave të qytetarëve gjatë procesit zgjedhor.

Çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka të drejtë të kandidojë për deputet mbi moshën 18 vjeçare.

Përveç funksionit legjislativ, ai ka edhe dy funksione të tjera, funksionin kontrollues dhe funksionin përfaqësues. Prej 120 deputetëve, 100 prej tyre janë qytetarë të kombit shqiptar, kurse 20 të tjerë janë prej komuniteteve të ndryshme jo shumicë si: romë, ashkalinjë, egjiptianë, serbë, turq, boshnjakë dhe goranë. Kuvendi ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“.

Rregullat që duhet të zbatohen dhe të respektohen nga qytetarët quhen ligje. Propozimet e ligjeve në Kuvend mund t'i bëjnë deputetët, Qeveria, Presidenti dhe populli. Me shqyrtimin e tyre merren komisionet parlamentare që ndryshe njihen si grupe punuese.

Kosova është një shtet me demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar.

Ne jetojmë në një shtet demokratik dhe ne të gjithë kemi të drejta të barabarta, andaj kur të rritemi duhet të punojmë për vendin tonë dhe duhet ta respektojmë atë.



Voto për një ndryshim



Ne jemi të barabartë





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Ali Kelmendi“  
Klasa: V-1  
Vendi: Vushtrri